



AKTI I NDIHMËS PËR PERSONAT E PASTREHË– MCKINNEY-VENTO

Nxënësit në Strehim të Përkohshëm – Udhëzues për Prindërit dhe të Rinjtë

TEMA	INFORMACION I RËNDËSISHËM
Fëmijët që jetojnë në situatat e mëposhtme konsiderohen pa strehë, për qëllime të të drejtave arsimore sipas Aktit McKinney-Vento:	- Në një strehë, motel, kamping, ose të braktisur në një spital. - Në një makinë, park, vend publik, autobus, tren, ose ndërtesë të braktisur. - Që jetojnë së bashku me të tjerë miq ose të afërm, për shkak se nuk mund të gjejnë ose përballojnë një banesë
Të Rinjtë e Pashoqëruar	Një i ri që nuk është nën kujdesin fizik të një prindi ose kujdestari dhe që jeton në një nga situatat e mësipërme. Këta të rinj kanë të njëjtat të drejta si nxënësit që jetojnë me prindërit ose kujdestarët e tyre. <i>Të rinjtë e pashoqëruar pa strehë kanë të njëjtat të drejta si nxënësit pa strehë që jetojnë me një prind ose kujdestar.</i>
Nxënësit që bien nën përkufizimin e Aktit McKinney-Vento për personat pa strehë kanë të drejtat e mëposhtme:	- Të marrin arsim publik falas. - Të regjistrohen menjëherë në shkollën e zonës, nëse ka vende të lira. - Të ndjekin shkollën pavarësisht sa kohë kanë jetuar në vendin ku qëndrojnë tani. - Të qëndrojnë në shkollën e origjinës (shkolla që ndiqnin përpara se të mbeteshin pa strehë ose shkolla e fundit që kanë ndjekur) ose të zgjedhin të ndjekin shkollën e re të zonës ku janë aktualisht të vendosur. - Të marrin shërbime transporti për të shkuar në dhe nga shkolla. - Të mos u refuzohet regjistrimi i menjëhershëm në shkollë vetëm për shkak të situatës së tyre ose mungesës së dokumentacionit të regjistrimit. - Të mos veçohen nga programi i rregullt shkollor për shkak se janë të pastrehë. - Të marrin vakte shkollore falas.
Informacion i Rëndësishëm:	- Çdo qark (borough) ka të paktën një Menaxher Rajonal të Programit STH, i cili shërben si lidhje për nxënësit në strehim të përkohshëm dhe drejton programet e shërbimit që ndihmojnë fëmijët pa strehë të vazhdojnë arsimin e tyre. Menaxheri Rajonal STH mbikëqyr një ekip Asistentësh Familjarë. Informacionin e kontaktit për Menaxherët Rajonalë mund ta gjeni këtu¹. - Çdo shkollë ka një Lidhës të Programit STH (STH School-Based Liaison) që punon drejtpërdrejt në shkollë për të mbështetur nxënësit në strehim të përkohshëm. - Disa shkolla kanë edhe një Koordinator Komunitar STH (STH Community Coordinator) që ofron mbështetje shtesë. - Për më tepër, Distrikti 75 dhe Distrikti 79 kanë secili një lidhës (lison) të caktuar STH, i cili ndihmon fëmijët pa strehë për të përmbushur nevojat e tyre arsimore. - Asistentët Familjarë (Family Assistants) ndodhen në strehimore dhe në disa shkolla. Ata janë përgjegjës për të ndihmuar prindërit pa strehë dhe fëmijët e tyre me nevojat e tyre arsimore.

¹ [A-101 Attachment 5 - Affidavit of Emancipation-Posted 3-1-18.docx](#)

TEMA	INFORMACION I RËNDËSISHËM
	Asistentët Familjarë janë të disponueshëm për të ndihmuar prindin e fëmijës me regjistrimin në shkollë, marrjen e vaksinimeve, sigurimin e dokumenteve shkollë, dhe organizimin e transportit për në dhe nga shkolla. Stafi i shkollës duhet të ndjejë liri të plotë për të kontaktuar lidhësin e shkollës STH, koordinatorin komunitar, ose menaxherin rajonal për pyetje individuale, trajnime ose për të ndihmuar të rinjtë e pashoqëruar.
Zgjedhja e Shkollës:	- Shkollat duhet t'u lejojnë prindërve të zgjedhin shkollën për fëmijën e tyre kur ai është pa strehë. Prindi mund të zgjedhë një nga opsionet e mëposhtme: - Shkollën që fëmija ndiqte kur kishte banesë të përhershme (shkolla e origjinës); - Shkollën ku nxënësi ishte regjistruar për herë të fundit; ose - Çdo shkollë që është në dispozicion për një fëmijë me banesë të përhershme që banon në zonën ku fëmija pa strehë po qëndron aktualisht, për sa kohë që fëmija plotëson kushtet e pranimi dhe ka vende të lira.
Regjistrimi në Shkollë: (Zbatohet vetëm nëse fëmija juaj nuk është aktualisht i regjistruar ose nëse dëshironi ta ndryshoni shkollën)	- Shkolla Fillore dhe e Mesme (Elementary & Middle School) - nëse keni një shkollë të përcaktuar sipas zonës suaj, mund ta regjistroni fëmijën drejtpërdrejt në shkollë në çdo kohë gjatë vitit shkollor. Nëse nuk keni një shkollë të përcaktuar sipas zonës ose dëshironi të shqyrtoni mundësi të tjera shkollash për fëmijën tuaj, vizitoni një Qendër Mirëseardhjeje për Familjet (Family Welcome Center). Për të gjetur vendndodhjen e Qendrës suaj të Mirëseardhjes, telefononi në 311. - Shkolla e Mesme e Lartë (High School) - të gjithë nxënësit e shkollës së mesme të lartë duhet të regjistrohen në një Family Welcome Center. - Nëse aktualisht po qëndroni në një strehë të Departamentit të Shërbimeve për Personat Pa Shtëpi të NYC (NYC Department of Homeless Services), asistenti familjar në strehën tuaj mund t'ju ndihmojë nëse është e nevojshme. Nëse nuk ka asistent familjar në strehën tuaj, ose nuk jeni në një strehë, ju lutemi kontaktoni Menaxherin Rajonal STH për ndihmë.
Mosmarrëveshje gjatë Regjistrimit:	- Nëse lind një mosmarrëveshje lidhur me shkollën që i është caktuar, nxënësi duhet të qëndrojë në shkollën e origjinës ose të transferohet në shkollën e re të caktuar, fëmija juaj duhet të regjistrohet përkohësisht në shkollën ku kërkon regjistrimin, derisa të zgjidhet mosmarrëveshja. - Prindit duhet t'i jepet një shpjegim me shkrim për vendimin e shkollës lidhur me mosmarrëveshjen, duke përfshirë të drejtën për apelim, dhe t'i bëhet referim për ndihmë të Asistenti Familjar STH, Lidhësi i Shkollës STH (STH School-Based Liaison) ose Menaxheri Rajonal STH.
Transporti	- Nxënësit që përkufizohen si pa strehë sipas Aktit McKinney-Vento kanë të drejtë për transport për në dhe nga shkolla, nëse është e nevojshme. Nëse është e mundur, nxënësve në klasat K–6 do t'u sigurohen autobusë shkollorë; nëse jo, ata kanë të drejtë për kartë MetroCard për nxënës. - Për nxënësit në klasat Pre-K–6 që kanë të drejtë për transport dhe marrin kartë MetroCard, prindërit e tyre kanë të drejtë për kartë transporti publik (MetroCard) për të shoqëruar fëmijën. - Nxënësit në klasat 7–12 kanë të drejtë për kartë MetroCard për nxënës.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni lidhësin STH të qarkut tuaj ose telefononi në 311.